



Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi
në mes të
Shoqatës Humanitare “Bereqeti”
dhe
Komunës së Gjakovës

Neni 1
Objekt i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Shoqatës Humanitare “Bereqeti”, e përfaqësuar nga Abdurrahman Bejtullahu, Koordinator i Shoqatës Humanitare Bereqeti në Gjakovë dhe në mes të Komunës së Gjakovës, e përfaqësuar nga Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës, me qëllim të financimit të projektit të ndërtimit të shtëpive apo për blerjen e banesave për personat në nevojë, varësisht nga rastet.

Neni 2
Kushtet dhe qëllimi i kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parasheh ndërtimin e shtëpive apo blerjen e banesave për personat në nevojë, sipas formës me çelësa në dorë, për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe të cilët nuk kanë kushte minimale banimi.

Neni 3
Obligimet e Palëve

- 3.1 **Shoqata Humanitare** është institucioni implementues i këtij projekti i cili parasheh ndërtimin e shtëpive sipas programit “çelësa në dorë apo blerjen e banesave me çelësa në dorë”, sipas rasteve të identifikuara.
- 3.2 Shoqata është e obliguar të raportoj për përfundimin e ndërtimit të këtyre shtëpive, si dhe për blerjen e banesave.
- 3.3 Raportimi duhet të bëhet me shkrim pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
- 3.4 Shoqata do të realizojë pjesën e saj të pagesës përmes transferimit bankar tek ofruesi i shërbimeve, si dhe tek kontraktuesi i shitblerjes. Të njëjtat ia paraqet edhe Komunës së Gjakovës.
- 3.5 Komuna e Gjakovës, do të participoj shumë e përgjithshme prej 10.000 Euro.
- 3.6 Shoqata Humanitare do të participoj vlerën tjetër deri në përfundimin e ndërtimit të shtëpive dhe blerjes së banesave sipas pikës 3.1 të kësaj marrëveshje për vitin 2022.

Neni 4
Afati i Realizimit

Afati i realizimit të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2022.

Neni 5
Interpretimi dhe Ndryshimi

- 5.1 Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke ruajtur parimin e reciprocitetit.
- 5.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga ana e dyja palëve.

Neni 6
Zgjidhja e Mosmarrëveshjes

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të zgjidhet me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.

Neni 7
Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuara në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 ditë para shkëputjes së sajë.

Neni 8
Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

P A L Ë T

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Abdurrahman Bajtullahu

Koordinator i Shogates

